



Deklaratë për shtyp – 360/05/2020

Plan kohor për hapjen e tregtisë, gastronomisë, hotelierisë, turizmit dhe panaiveve të tregtisë

10.05.2020
Faqja 1 nga 3

Zyra për shtyp e
kancelarisë së shtetit
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
ose 0211 837-1151

Pinkwart: Ne mbështetemi në aksesin e përgjegjshëm dhe të kujdesshëm të tregut, në mënyrë që kompanitë dhe punonjësit e tyre të mund të marrin pjesë në trendin në rritje.

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

Ministria e Ekonomisë, Inovacionit, Dixhitalizimit dhe Energjisë ju informon:

Qeveria e Republikës ka prezantuar një plan për hapjen e sektorëve të gastronomisë, hotelierisë dhe turizmit, të cilat janë goditur rëndë nga kriza. Si rrjedhim, nga 11 Maji e në vazhdim do të hapen gradualisht për publikun nën masa mbrojtëse të rrepta restorantet, shtëpitë e pushimit, vendet për kamping dhe hotelet. Kufizimet e hapësirave në lidhje me koronavirusin nuk do të jenë më të vlefshme dhe do të jetë e mundur të organizohen panaire tregtie duke filluar nga fundi i muajit maj. Të gjitha hapjet i nënshtrohen kushtit që situata e infeksionit të mos përkeqësohet. Kjo deklaratë u krye nga Ministri i Ekonomisë Prof. Dr. Andreas Pinkwart.

Pinkwart: „Ringjallja e ekonomisë është urgjentisht e nevojshme. Kjo ndodh sepse jemi në krizën më të madhe që nga Fundi i Luftës së Dytë Botërore. Shumë tregtarë kanë pësuar humbje masive. Rrjedhimisht jam i gëzuar që të gjitha bizneset, pavarësisht madhësisë, do të lejohen të hapen që prej 11 Majit. Kjo sjell impulse të reja blerjesh dhe situata e fitimeve të bizneseve mund të përmirësohet sërish.

Për më tepër, ne po e përdorim projektin që kemi përpunuar për të hapur me kujdes dhe me përgjegjësi sektorët e turizmit dhe të gastronomisë, të cilët janë më të goditurit. Hap pas hapi gastronomët dhe hotelierët duhet të arrijnë xhiron që kanë arritur para krizes - vetëm kështu ata mund t'i japin perspektivë 150.000 punonjësve të tyre.

Si përfundim, nëse situata me infeksionin nuk përkeqësohet, do të zhvillohen shpejt panaire dhe kongrese tregtie në kushte të rrepta, duke e bërë Nordrhein-Westfalen një pioner në Gjermani.

Në secilën nga këto hapa, ne ruajmë një balancë midis mbrojtjes së shëndetit dhe hapjes së ekonomisë dhe të shoqërisë, në mënyrë që mos t'i rrezikojmë arritjet e deritanishme“

Për rifillimin e sektorit të gastronomisë më 11 Maj vlejné veçoritë e mëposhtme:

Njerëz nga dy familje mund të ulen në një tavolinë. Nuk ka kufizime në lidhje me numrin e personave. Tavolinat duhet të jenë 1,5 m larg nga njëra-tjetra.

Instruktionet për pozicionimin dhe regjistrimet personale mundësojnë gjurmimin. Në mënyrë që të balancohen flukset e vizitorëve, Nordrhein-Westfalen nuk vendos kufizime në lidhje me koronavirusin për sa i përket orëve të hapjes dhe kohëzgjatjes së qëndrimit në restorante. Bufetë nuk lejohen.

Hapje të tjera më 11 Maj:

Shtëpitë dhe apartamentet e pushimit/Kampingu
Parqet zbavitëse/Anije për ekskursion

Hapje më 18 Maj:

Qëndrime turistike gjatë natës nga nënshtetasit duke përfshirë shfrytëzimin e ofertës së gastronomisë

Hapje e planifikuar më 30 Maj:

Panaire tregtie me planifikime për higjienën dhe numër të limituar pjesëmarrësish sipas sipërfaqes së eventit

Udhëtime turistike me guida me numër të limituar pjesëmarrësish
Banjo termale dhe pishina

Të gjitha detajet mund të gjenden në faqen e Ministrisë së Ekonomisë, Inovacionit, Dixhitalizimit dhe Energjisë të Republikës së Nordrhein-Westfalen (www.wirtschaft.nrw) . Standartet e vlefshme të mbrojtjes nga infeksionet dhe të higjienës gjenden [në këtë link](#).

Kontakti për shtypin: Matthias.Kietzmann@mwide.nrw.de

Nëse keni pyetje të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni zyrën e Ministrisë së Ekonomisë, Inovacionit, Dixhitalizimit dhe Energjisë, Telefon 0211 61772-204 (Matthias Kietzmann).

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës www.land.nrw

Faqja 3 nga 3

[Njoftim për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me rrjetet sociale](#)